

**Statuti dhe Akti i Themelimit
I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“ALTEAS” sh.p.k**

Forma e Shoqerise

Neni 1

Sot, me 31.07.2023 un themeluesja, Silvana Qose, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “ALTEAS” sh.p.k. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti I Themelimit dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Akti I themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo ceshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Themeluesit te shoqerise jane:

1. Silvana Qose ,shtetas shqiptar, I datelindjes 17.12.1989 lindur ne Berat banues ne Kolonje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I kartes ID me nr. 032526965 dhe nr. personal 196217001N.

Qendra e Shoqerise

Neni 2

Selia e Shoqërisë “ALTEAS” sh.p.k. ndodhet ne adresën: Qarku Fier ,Bashkia Lushnje , Lagjja pallatet e Termetit, Rruga Altin Mino godine 3 kateshe me nr 12, ne katin e pare Zona kadastrale 8532 , numer pasurie, 5/1306. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar.

Objekti I veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Rimbushje elektronike E-topup. Vodafone,One,celulare, Aksesore celularesh Siguracione automjetesh etj.

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.



Kapitali I shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 (Njeqind mije) Leke .

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga nje (nje)kuot me vlere te pergjithshme prej 100 000 leke. Kjo kuote i perket ortakut si me poshte:

1.Silvana Qose zoterues e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100 000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 8

Ortaku i shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tij nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci I shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 9

Emertimi I shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve si dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Kompetencat e ortakeve

Neni 11

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, ortakut shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.

Kane te drejte te miratoj ne bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.

Ata emerijne administratoret, zevendesit, ekspertet dhe revizoret kontabel.

Ata aprovojne cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencat e tyre
Miratoj ne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit
Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
Bejne transferimin e kuotave te te tretet
Bejne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin
e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender ankande
ose aktivitete te tjera te rendesishme
Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise.
Kane te drejte te bejne modifikimin e kontrates se shoqerise,etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me
te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Administrimi

Neni 13

Administratore e shoqerise eshte Silvana Qose, shtetase shqiptare, e datelindjes 17.12. 1989 lindur ne
Berat banues ne Kolonje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I kartes ID me nr.
032526965 dhe nr. personal I96217001N.
Afati i mandatit eshte 5 (pese) vjet.

Neni 14

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administrator te deleguar ose perfaqesues te thjeshte
per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin
dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje regullore te brendshme te shoqerise.

Neni 15

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te
kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke
perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe Statut qe I takojne ortakeve. Raporti I administrimit,
inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

Marredheniet e punes

Neni 16

Marredheniet e punes regullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi.
Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te
respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen
per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.



Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori I shoqerise.

Ekspertet ose revizoret kontabel

Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise I besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Viti financiar, bilanci vjetor, shperndarja e fitimeve

Neni 19

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti I pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit. Miratimi I dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 muajve qe nga fundi I vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet

Neni 20

Veprimtaria ekonomike do te mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Administrator imerr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten I kalojne ortakeve te shoqerise.

Neni 21

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

Shperndarja dhe likuidimi I shoqerise

Neni 22

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqerise



Neni 23

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve të administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vëlosur.

Dispozita të përgjithshme

Neni 24

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit", Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerrë ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

"ALTEAS" sh.p.k.

Silvana Qose



Lushnje me, 01.08.2023